

## **Udhezues per familjet e studenteve jo italiane**

### **1. Kush jemi**

Istituti Permbledhes i Barbarano Viçentines drejton mesimdhënien e femijeve dhe te rinjeve

- nga 3 deri ne 6 vjeç,me kopshtin e femijeve
- nga 6 deri ne 11 vjeç ,me shkollen fillore
- nga 11 deri ne 14 vjeç, me shkollen tetevjeçare

### **2. Ku jemi**

Qendra e drejtorise dhe e sekretarise ndodhen ne BarbaranoViçentina, rruga 4 novembre 82/84(prane shkolles tetevjeçare)

Para se te çoni femijet tuaj ne çdo lloje shkolle eshte e nevojshme te prezantoheni ne sekretari, ne rrugen 4 Novembre, 82/84 ne Barbarano Viçentino, tel 0444 886073, per te plotesuar proçeduren e rregjistrimit.

#### **Kopshtet e femijeve ndodhen**

- ne Barbarano Vicentino,rruga Vittorio Veneto:tel. 0444 886115.Orario i aktivitetit mesimor: nga e hena deri te premten,nga ora 8.00 -16.00.Shoqerimi i femijeve ne mengjes mund te filloje ne oren 7.30 (ne baze te kerkeses se arsyeshme te prinderve).
- ne Ponte di Mosano, ne Piazza Libertà,tel. 0444 896793.orari i aktivitetit mesimor nga e hena deri te premten,nga ora 8.00 -16.00.shoqerimi i femijeve ne mengjes mund te filloje qe nga ora 7.30 (ne baze te kerkeses se arsyeshme te prinderve).

#### **Shkollat fillore ndodhen**

- ne Barbarano Vicentino ,Rruga Zonato,1 tel 0444776147. Orari i aktivitetit shkollor:nga ora 7:55 deri ne oren 12:55, nga dita e hene deri te shtune.Shoqerimi i nxenesve ne mengjes fillon ne oren 7:35(me kerkese te arsyeshme nga prinderve)
- ne Ponte Barbarano, rrugica Crispi,1 tel.0444 896580. Orari i aktivitetit shkollor: nga ora 8:45 deri ne oren 13:05, nga dita e hene deri te shtune.Shoqerimi i nxenesve ne mengjes fillon ne oren 7:35 (me kerkesen e arsyeshme te prinderve)
- ne Belvedere Villaga, rruga Belvedere, tel 0444 884505. Orari i aktivitetit shkollor: paradite nga dita e hene deri te enjte nga ora 8.10 deri ne oren 15.10; te premten nga ora 8.10 deri ne oren 12.10. Shkolla eshte e hapur nga dita e hene deri te premten.
- Ne Mossano, rruga Garibaldi, tel. 0444 886459. Orari i aktivitetit shkollor: te henen,te merkurren e te premten nga ora 8.00 deri ne oren 12.40.Te marten dhe te enjten nga ora 8.00deri ne oren 16.00. Shkolla eshte e hapur nga dita e hene deri te premten.Shoqerimi i nxenesve ne mengjes fillon ne oren7.30 (me kerkesen e arsyeshme te prinderve)

### Shkolla tetevjeçare ndodhet :

- Ne Barbarano Vicentine, rruga 4 novembre,82/84. Orari i aktivitetit shkollor nga ora 7.55 deri ne oren 12.55 nga dita e hene deri te shtune. Shoqerimi inxenesve ne mengjes fillon ne oren 7.30(me kerkesen e arsyeshme te prinderve).

### 3. Rregullat tona

#### Per mesuesit

- a) Ne çdo shkolle mesuesi gjendet 5 minuta para se te filloje mesimi paradite o mbasdite.
- b) Kontrollon qe nxenesit te kene nje paraqitje te rregullt dhe veshje te pershtatshme per shkollen dhe heq materialet e papershtatshme,duke ja dorezuar prinderve ose vete nxenesve ne fund te orarit mesimor.
- c) Shenon detyrat e shtepise dhe verifikon se ato jane kryer.
- d) Mundohet te shmang largimin nga klasa, vetem per arsye te domosdoshme dhe pasi te kete siguruar mbikqyrjen e nxenesve nga personeli i sherbimit.
- e) Mbikqyre me kujdes sjelljen e nxenesve ne klase dhe gjate zhvendosjeve te mundshme brenda dhe jashte shkolles, si dhe gjate eskursioneve te programuara dhe te autorizuara.
- f) Ne fund te mesimit shoqeron nxenesit ne porten e jashtme te shkolles , nuk ben pjese ne detyrat e mesuesit mbikeqyrja e nxenesve jashte territorit qe nuk i perket shkolles.
- g) Perdor veshje, sjellje dhe nje menyre te foluri te pershtatshme me vleren e caktuar edukative te rolit te tije.
- h) Nuk perdor celularin gjate ores se sherbimit, duke mbajtur mbyllur ate; ne rast te nevojshem dhe urgjent perdor telefonin qe ndodhet ne shkolle.
- i) Mesuesi pergjegjes ne shkolle, i ngarkuar ne mirepritjen e nxenesve te huaj, cakton, brenda nje kohe te shkurter, nje takim me familjen e nxenesit dhe se eshte e nevojshme, me *ndermjetesin(mediatorin) kulturor*, per te mbledhur informacione mbi perparimin shkollor dhe shpjegon rendesine e rregullores se Istitutit dhe rregullat e brendeshme (qarkoret, skedat e vleresimit, detyrat e shtepise, sigurimin, administrimin e mungesave...)

#### Per nxenesit

- a) Klasa ku do te hyje nxenesi do te korrispondoje moshes se tije:  
*“Mbetet e rendesishme kriteri i pergjithshem i hyrjes se nxenesit sipas moshes”- artikull.45i D.P.R. 394/99*)ma mund te jete me pak ose me shume se nje vite pasi eshte percaktuar niveli qe nxenesi zoteron.
- b) Kur bie zilja e shkolles nxenesi hyn ne shkolle o ne klase i shoqeruar nga mesuesi.  
**Ne raste vonese eshte i detyruar te sjelle justifikimin ne ditin pasardhese.**
- c) **Eshte e rendesishme ardhja ne shkolle me nje veshje te rregullt, te pershtatshme per ambjentin dhe ne kushte te mira igjenike.**
- d) **Te paraqitet ne shkolle i pajisur me materialet e nevojshme dhe te kete plotesuar detyrat qe jane dhene per ne shtepi, si ato me goje(per te mesuar) dhe ato me shkrime.** Nuk duhet te sjelle ne shkolle gjera qe nuk i nevojiten aktivitetit shkollor, veçanerisht ato qe mundt te krijojne shqetesime. Ne raste se do te sjelle ne shkolle gjera jo te pershtatshme, mesuesi eshte i autorizuar qe t’ja heq ato, duke ja dorezuar direkt prinderve. Personeli shkollor nuk mban pergjegjjsi per te ruajtur ato.
- e) **Duhet ti drejtohet ne menyre korrekte shoqeve dhe te respektoje te gjithe personelin e shkolles. Te perdore ne çdo rast nje menyre te foluri korrekte dhe te kontrolluar.**
- f) Per sa i perket Istitutit Shkollor, te perdore me kujdes strukturat, mobiliet, mjetet dhe çdo gje qe ndodhet ne shkolle ne menyre qe te mos krijojne deme per pasurine e shkolles dhe te jete i pergjegjeshem qe sjelljet e padeshiruara e qe krijojne deme,jane objekt i çdemtimit ekonomik per demtuesin.

- g) Ne fund te mesimit te dale nga shkolla ne menyre te rregullt dhe te qete nen vezhginim e mesuesve.
- h) Eshte e ndaluar perdorimi i telefonit celular ne shkolle.

### **Per prinderit**

- a) Prinderit duhet te ndihmojne femijet e tyre qe te organizohen ne menyre te tille qe te respektojne rregulloren e shkolles, **ne vecanti orarin e shkolles, te zhvillojne me korrektesi detyrat e shtepise, te kontrollojne vazhdimishte librezet e komunikimive shkoll-familje, te kthejne me shpejtesi lajmerimet dhe provimet qe jepen per njoftim prinderve;**
- b) **Te marrin pjese ne takimet individuale o kolektive, te komunikojne me shkrime kerkesat per mesuesit, justifikimet per mungesat dhe vonesat.**
- c) **Duhet te kontrolloje higjenen dhe veshjen e femijeve dhe te informohet mbi sjelljen e tyre ne shkolle dhe gjate rruges shkolle/shtepi e anasjelltas, ne menyre te vecante ne rast se perdorin autobuzin e Komunes;**
- d) Te bashkepunojne me mesuesit per te perballuar gjendje te veshtira qe mund te krijohen me femijet duke lehtesuar sgjidhjen e tyre;
- e) Te aktivizohen per te njohur organizimin e shkolles, duke mbajtur parasysh qe nevojat personale duhet te jene te dokumentuara, duke zbatuar nje rregull te pergjithshem.

### **Shpalljet**

Eshte e njohur dhe e garantuar te gjithe perbersve te shkolles mundesia te ngjisin shpallje dhe lajmerime ne vendet e posaqme, ne teritorin e shkolles me kushtin qe kush firmos mban pergjegjesine, qe nuk jane te paligjshme dhe permbajtja e tyre ti pershtatet aktivitetit shkollor dhe marrdhenieve shkoll-familje.

### **Takimet prinder-mesues**

Organizimi i takimeve me familjet eshte i publikuar nepermjet POF. Ato do te jene scadenze dymujore dhe jane ndertuar ne orare te pershtateshme per prinderit ne menyre qe te lehtesojne pjesmarrjen e tyre.

Prinderit mund te kerkojne, paraprakisht me takim, te takojne mesuesit ne periudhen midis asambleve, sipas menyrave te meposhteme:

- Ne orarin qe nuk koinçidon me aktivitetin mesimor;
- Ne orarin qe nuk koinçidon me mbikqyrjen e nxenesve.

### **Mungesat- Vonesat -Justifikimet**

**Mungesat.** Te gjitha mungesat duhet te jene te justifikuara nga prinderit. Ne qofte se mungesa zgjate me shume se 5 dite mesimimore dhe eshte per arsye shendetesore, prinderit duhet te prezantojne nje certifikate mjeksore. Eshte detyre e tyre te informojne paraprakisht mesuesit ne qofte se mungesa eshte per arsye familiare. Mesuesit kane per detyre te perkujdesen per shendetin e nxenesve dhe te bejne te ditur Drejtorise ne raste te semundjeve te renda infektive. Gjithashtu kane per detyre te mos rikthejne ne shkolle nxenesit qe kane pasur semundje infektive, pa certifikate mjeksore .

Per mungesa qe zgjasin me shume se 10 dite eshte detyre e menjehershme e prinderve te lajmerojne mesuesit. Ne qofte se prinderit nuk do te bejne lajmerimin e duhur, eshte detyre e mesuesit te lajmeroje zyren e sekretarise. Do te jete gjithashtu detyre e mesuesit te informoje zyren e sekretarise ne qofte se nxenesi nuk vjen rregullisht ne shkolle.

**Vonesat.** Ato duhet te jene te justifikuara me shkrim ose drejteperdrejte nga personi qe shoqeron femijen ne shkolle.

**Dalja nga shkolla para orarit.** Femija i dorezohet zakonisht prinderit, te afermeve o miqeve duke infirmuar paraprakisht me shkrim, ne fillim te mesimit, mesuesin e klases. Ne rast te komunikimit ne telefon, personi qe merr ne dorezim femijen duhet te jete i njohur nga mesuesi.

Jane te ndaluara daljet para orarit ne menyre te vazhdueshme per te favorizuar aktivitetet jashte shkollore. Perkundrazi jane te justifikuara ato per arsye mjeksore dhe realibitimi.

**Dalja nga kopshti para orarit.** Ne qofte se femija nuk ha dreke ne menses e kopshtit prinderit mund ta marrin femijen nga kopshti para orarit te menses.

Me kerkese me shkrime te prinderve, nxenesit e shkolles tetevjecare qe kthehen ne shkolle edhe mbasdite, mund te dalin nga shkolla mbas orarit te paradites pa prezencen e prinderve.

### **Aktivitetet sportive ne shkollen tetevjecare**

Aktiviteti sportiv i pergjigjet domosdoshmerise edukative dhe ka per qellim zhvillimin fizik te nxenesit.

Ne qofte se eshte e nevojshme, qe per motive shendetesore nxenesi te mos marr pjese, prinderit duhet te prezantojne kerkese me shkrime Drejtorit te shkolles, per te pasur perjashtim te pjeseshem o te pergjithshem, te perkohshem ose te perhershem nga edukimi fizik, te shoqeruar me çertifikate mjeksore. Kjo kerkese, ne qofte se do te merret parasysh, nuk e perjashton nxenesin nga pjesemarrja ne leksionin e edukimit fizik, por vetem nga disa aktivitete qe nuk pershtaten me gjendjen e tij fizike. Mesuesi mund te vleresoje nxenesin vetem me pjesen teorike te lendes.

### **Porta me kangjella**

Porta me kangjella e oborrit te shkolles hapet gjysem ore para se te filloje mesimi, megjithate hapet para se te arrije autobuzi i shkolles dhe bashkepunetori shkollor i turnit ka detyre qe te mbikqyre nxenesit..

Vezhgimi e nxenesve ne oborrin e shkolles para se te filloje mesimi behet ne base te kerkeses se prinderve, per arsye pune.

Prinderit e femijeve te kopshtit mund te shoqerohje femijet e tyre brenda ne shkolle gjate kohes se pritjes.

Ne rast aksidenti, mesuesi pergjegjes i faktit do te kujdeset per te informuar Zyren e Sekretarise dhe familjen; ne rast aksidenti te rende preokupohet te lajmeroje ndrhyrjen urgjente dhe prinderit. Pas lajmerimit telefonik niset lajmerimi me shkrime per Drejtorin e Shkolles dhe, se eshte e nevojshme, denoncimi ne shoqerine e sigurimit.

### **Perdorimi i ambjenteve te menses**

Ne rast se kerkesat per sherbimin e mences jane me te medha se vendet ne dispozicion, formohet nje liste ne base te kriterëve te meposhtme:

- 1) Perdorimi i autobuzit te shkolles
- 2) Kerkesat e punes se prinderve
- 3) Largesia e banimit nga shkollla

### **Escursionet**

Ndahen ne:

- a) Eskursione te shpejta dhe vetem te nje klase qe zhvillohen brenda ores se mesimit te mesuesit qe i organizon;
- b) Escursione qe organizohen me nje o disa klase dhe zgjasin gjithe ditën;

- c) Escursionone qe zgjasin nje o disa dite. Organizimi didaktik i takon mesuesit qe organizon escursionin.

Mesuesi qe do te organizoje nje visite te tille duhet te kerkoje autorizimin e drejtorit te shkolles, pastaj do t'ju kerkoje prindreve nje deklarate me shkrim ne te cilen eshte shkruar qe prinderit autorizojne femijen qe te marri pjese ne kete vizite, ku te jete shkruar emri i femijes si dhe vendi ku do te shkohet. Asnje nxenes nuk mund te marre pjese pa autorizim. Autorizimet duhet te dorezohen ne skretari bashke me kerkesen.

Per shkembimet kulturele parashikohet strehimi ne familje, me detyrime reciproke per pjesemarresit.

### **Perdorimi i mjeteve private**

Eshte e ndaluar qe prinderit te shoqerojne nxenesit ne eskursionone me mjetet e tyre (vetura, furgona) ne orarin e shkolles.

### **Rregjistrimi ne kopesht**

Kriteret e regjistrimit ne kopesht, qe zbatohen sipas renditjes se meposhtme:

- a) Femije te regjistruar brenda skadences se parashikuar nga normativa;
- b) Femijet qe banojne ne komunen ku ndodhet shkolla;
- c) Femije qe kane qene ne te njejten shkolle gjate vitit te kaluar, ose kane qene ne listen e pritjes;
- d) A) Femije pa prinder  
B) Femije vetem me nje prind  
C) Femijet qe vijne nga familje qe gezojne assistenze komunale.
- 5) Femije 4 ose 5 vjeç qe nuk jane regjistruar;
- 6) Femije qe kane vellezer o motra me te medhenj ne kopesht;
- 7) Femije qe kane vellezer o motra ne shkollen fillore afer kopshtit;
- 8) Femije ne gjendje te veçante te cikluara nga ULSS (Shoqeria shendetsore e zones);
- 9) Femije me te dy prinderit qe punojne;
- 10) Ne kushte te barabarta kane perparesi femijet qe jane me te medhenj ne moshe;

Rregullsia do te jete i kontrolluar ne menyre periodike dhe e vleresuar nga Drejtuesi i shkolles ne baze te normave ne fuqi.

Kriteret e formimit te klasave ne kopesht:

- 1) Klasat mund te jene te njejtes moshe ose me mosha te ndryshme. Ne rast se klasa eshte me mosha te ndryshme per te krijuar nje ekuiliber brenda tyre ndiqen keto kriteret:
  - a) Viti i lindjes se femijeve, ne raport midis gjashtemujorit te pare dhe te dyte;
  - b) Raport i barabarte midis vajzave dhe djemeve;
  - c) Afersia me banimin.

### **Rregjistrimet ne shkollen fillore**

Kriteret e regjistrimit per shkollen fillore.

Ne rregjistrimet e shkolles fillore kane perparesi banoret e komunes. Kerkesat e regjistrimit per banoret jashte komunes diskutohen dhe vendosen nga Keshilli i Istitutit, ne baze te kriterëve te vendosura nga Keshilli si vijon:

- a) Pershtatshmeri me amjentin e shkolles;
- b) Pershtatshmeri me numrin e mesuesve;
- c) Ne qofte se kopshtin e ka bere ne te njejten komune;
- d) N.q.se sherbimi i transportit jepet nga Administrata komunale;
- e) Afersia e banimit me shkollen;
- f) Orari dhe qendra e punes se prinderve.

Klasat e shkolles fillore duhet te jene midis tyre homogjene ne heterogjenalitetin e tyre (te brendshem). Ato formohen brenda 10 diteve te para te vitit shkollor, mbas nje takimi me mesueset e

kopshtit per te njohur nxenesit, per te percaktuar nivelin e tyre per te kuptuar, sjellen ne shkollë dhe problemet e mundshme, si dhe njohjen e drejteprdrejte te nxenesve nga ana e mesuesve, e integrimin per sa eshte e njohur.

### **Regjistrimi ne shkollen tetevjecare**

Rregjistrimi ne klasen e pare behet zyrtarisht, si kalim nga klasa e peste e filllores.

Klasat formohen duke pasur parsysh kriteret e meposhtme:

- a) Larmi te brendshme per aftesite e fituara;
- b) Ekuiliber ne raportin djem-vajza, nxenes te huaj, invaliditet;
- c) Komuna dhe fraksioni i banimit.

### **RREGULLORJA E DISIPLINES**

Sjelljet qe konsiderohen si mungese e disiplines jane thyerja e normave te detyrave te studentit dhe te funksionimit korrekt te raportit ne brendesi te shoqerise shkollore.

Per sjellje te tilla jane parashikuar masa paraprake qe synojne tu bejne te ditur pergjegjesve shkeljen e normave te shkaktuara nga veprimet e tyre, te ndalojne perseritjen e tyre, te lehtesojne korrigjimin e veprimeve te parregullta, dhe ne fund, te arrijne ne riparimin e demit.

Shkelja e rregullave do te sjell zbatimin e masave disiplinare ne base nivelit te shkeljes dhe vleres se demit te provokuar , ne doreheqjen e tyre: terheqje vemendje, pune suplementare(edhe te dobishme per shoqerine), verejtje me shkrim, verejtje me shkrim ne rregjistrin e klases, komunikimi-thirrja e prinderve, nderhyrja e Drejtorit te shkolles-Keshillit te klases, nderprerja nga mesimi.

Ndeshkimet do te behen ne menyre te menjehershme me qellim qe te mos zvogelohet vler edukative te tyre.

Pergjegjesia eshte personale dhe asnjeri nuk mund ti nenshtrohet masave disiplinare pa u ftuar me pare te thote arsyet e tije.

NATYRA E SHKELIES	MASA DISIPLINARE DHE ORGANI KOPETENT
Mungesa e detyrave shkollore: Nxenesi nuk ben detyrat dhe prezantohet ne shkollë pa materjalet e duhura	Terheqje vemendje nga ana e mesuesit. Se veprimi perseritet, shkelia shenohet ne rregjistrin e klases,lajmerohen me shkrim prindrit dhe thirren ne shkollë.
Nxenesi sjell ne shkollë materiale qe nuk i nevojitet aktivitetit shkollor.	Terheqje vemendje nga ana e mesuesit dhe komunikim me shkrim prinderve. Materiali ne fjale sekuestrohet dhe do t'ju jepet vetem prinderve qe do ta kerkojne.
Nxenesi nuk sjell te firmosur nga prinderit ne kohen e catuar provimet qe i jane dorezuar	Nuk do te jepen me per ti pare ne shtepi provimet qe do te vijojne. Prinderit mund ti shikojne ato ne shkollë.
Nxenesi nuk respekton ambientin e shkolles duke e ndotur e demtuar ate.	Mesuesi duke verifikuar demin, e shenon ne rregjistrin e klases mer masat per te kthyer ne gjendjen e meparshme ambientin ose mobiljet e demtuara me shpejtesi.

<p>Perdore ne menyre jo te rregullt materialet dhe mjetet shkollore, duke shkaktuar deme.</p>	<p>Ne raste te demtimeve te medha, mesuesi lajmeron Drejtorin e shkolles me qellim qe te informohen prinderit qe nxenesi (qendron ne shkolle jashte orarit deri sa te riparoje demin e shkaktuar) ditën e ardhme nuk mund te marr pjese ne oren e mesimit per te riparuar demin. - Mund te kerkohet demshperblim ekonomik.</p>
<p>Nxenesi pasqyron nje sjellje pak te kontrolluar te rrezikshme per veten dhe te tjeret ne momente te ndryshme te jetes shkollore. Tregon mungese respekti me shoket dhe personelin e shkolles, perdor nje fjalar vulgare (mallkon dhe thote fjale te ndyra) Me sjelljen e tij pengon dhe sprish bashkejetesen civile dhe rezultatin ne shoqerine e shkolles.</p>	<p>Terheqje vemendje.  Përoçes verbal ne libezen personale nga ana e mesuesit qe zbulon aktin ose nga Drejtori i shkolles  Akti shkruhet ne regjistrin e klases dhe prinderit thirren ne shkolle.  Ne rast te sjelljeve veçanerisht te renda o te perseritura qe shoqerohen me deme kunder personave dhe te sendeve, vendoset nderprerja nga mesimi ne baze te propozimit te Keshillit te Klases, me detyrim te ardhjes ne shkolle per te studiuar ne menyre personale.</p>









































































